



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Rama: Vepro! me 'Shpejtësinë e skiterës' për rrugat e vetat Dyerit e Thesarit i hap vetëm Kuvendi
- 2

'Sazani'/ Rama: S'ka shitje, shteti do të jetë partner! Nano e Berisha tentuan ta kthenin në destinacion turistik, 2 projekte të tjera gjatë qeverisjes sime nuk u realizuan
- 3

'Një shkrimtar i shkollës së Xhelil Gjonit në zyrën e tij në Komitetin Qendror dhe i kërkojë që të jepsë dorëheqjen', dëshmia e rrallë e Zija Çelës
- 4

Ardi Stefa: Mbrojini fëmijët nga shkolla
- 5

Butrint, 1928

Kronikë

Zbulohet dyqan me mallra kontrabandë në Durrës, arrestohet pronari! Sekuestrohen qindra paketa cigare dhe fishekzjarrë (VIDEO)

Policia thotë se në dyqan shiteshin cigare dhe fishekzjarrë të dyshuara të kontrabanduara, ndërsa pronari dyshohet se fshihte edhe të ardhurat nga aktiviteti.

Zbulohet dyqan me mallra kontrabandë në Durrës, arrestohet pronari!
Report TV



Watch on

Redaksia
11 Shtator, 13:06 | Përditësimi: 11 Shtator, 13:18

Share Post



Një 46-vjeçar ka rënë në prangat e policisë në [Durrës](#), pasi në dyqanin e tij u zbuluan qindra paketa [cigare](#) dhe [fishekzjarrë](#) të dyshuara të kontrabanduara.

Arrestimi u bë gjatë operacionit të koduar "Illegality", të zhvilluar nga specialistët e Kriminologjik-Financiar të DVP Durrës. Sipas policisë, kontrolli u ushtrua në një dyqan në lagjen nr. 14, ku u konstatua se shiteshin cigare dhe fishekzjarrë të llojeve të ndryshme, të dyshuara të kontrabanduara. Po sipas hetimeve, pronari dyshohet se fshihte edhe të ardhurat e përfutuara nga shitja e këtyre mallrave.

Në pranga përfundoi pronari i dyqanit, R. D., 46 vjeç, banues në Tiranë. Ai akuzohet për kontrabandë mallrash me akcizë, tregtim dhe ruajtje të mallrave kontrabandë, fshehje të të ardhurave, si edhe mospagim taksash e tatimesh.



LEXO EDHE:
'Po vijnë shirat, rrezikojmë të përmytemi sërish', banorët e ish-Kënetës në Durrës protestojnë ndaj bashkisë: Duam investime! Bllokojnë rrugën

Materialet i kaluan Prokurorisë së Durrësit për veprime të mëtejshme.

Njoftimi për shtyp

"Zbulohet një dyqan ku shiteshin mallra të ndryshme të dyshuara të kontrabanduara. Vihet në pranga pronari i dyqanit, i cili fshihte të ardhurat e përfutuara nga shitja e mallrave.

Sekuestrohen qindra paketa me cigare dhe fishekzjarrë, të dyshuara të kontrabanduara. Në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e kontrabandës së mallrave, specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare të DVP Durrës, bazuar në informacionet e siguruara nëpërmjet inteligjencës informative, finalizuan operacionin e koduar "Illegality".

Gjatë operacionit u ushtrua kontroll në dyqanin e shtetasit R. D., në lagjen nr.14, Durrës, ku nga kontrollat dhe verifikimet rezultoi se shiteshin fishekzjarrë dhe cigare të llojeve të ndryshme, të dyshuara të kontrabanduara, si dhe fshiheshin të ardhurat e përfutuara nga shitja e tyre.

Në vijim të veprimeve, u arrestua në flagrancë pronari i dyqanit, shtetasi R. D., 46 vjeç, banues në Tiranë, për veprat penale "Kontrabanda me mallra me të cilat paguhet akcizë ose me pezullim të plotë apo të pjesshëm nga detyrimet doganore ose të akcizës", "Tregtimi dhe transportimi i mallrave kontrabandë", "Ruajtja ose depozitimi i mallrave kontrabandë", "Fshehja e të ardhurave" dhe "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme" \

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

U.D/E.H/Shqiptarja.com

TAG: [cigare](#) [fishekzjarre](#) [Durres](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? 1.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:
Ngërci për pagat e drejtësisë, kujt i jepni të drejtë?

7 Shtator, 07:56

[Qeverisë](#)

[Magjistratëve](#)

[Nuk e di](#)

Lajme të tjera




'Policia, shtrihu' i shpallur në kërkim për plagosje arrestohet 19-vjeçari në Shijak! Momenti kur Operacionalja mësyn banesën e të riut (EMRI+VIDEO)

11 Shtator, 13:30



Me armë pa leje, pranga pronarit të hotelit në Fushë-Krujë, i sekuestrohen edhe 20 mijë euro! I arrestuar edhe në 2017 për tentativë vrasjeje (EMRI)

10 Shtator, 23:16



Ujërat e ndotur në Durrës, projekt për përmirësimin e infrastrukturës! Investimi financohet nga Bashkimi Europian dhe Agjencia Franceze e Zhvillimit

9 Shtator, 20:34



Kavajë/ Zjarri përfaqësi sipërfaqe të mëdha në Bago, shmanget rreziku ndaj dy banesave! Sfidë terreni i vështirë, kërkohet ndërhyrje nga ajri

9 Shtator, 15:59



Sekuestrohen në Portin e Durrësit 107.7 kg kanabis me THC të lartë, vlera rreth 1.2 mln €! Vinte nga Kanada, në kërkim 2 shqiptarë të Kosovës (VIDEO)

9 Shtator, 15:05



Nisin punimet për impiantin e ujërave të ndotura në Durrës, Karakaçi: 85 mln euro grant nga BE! Projekti parashikon 113 km rrjete të reja (VIDEO)

9 Shtator, 12:57



Superjahti 450 milionë dollarësh i pronarit të Manchester City ankorohet në Durrës! Do të furnizohet me 700 mijë litra naftë (VIDEO)

9 Shtator, 12:50



E hëna nis me bilanc tragjik në rrugët e vendit, 2 të vdekur nga aksidentet në Fier e Durrës dhe 15 të plagosur (EMRAT+VIDEO)

7 Shtator, 08:41



PL: Bashkia tu përgjigjet qytetarëve se ku shkojnë paratë për menaxhimin e mbetjeve në Durrës

5 Shtator, 16:26




Tritoli me celularin pranë makinave të parkuara në Durrës, policia arreston dy të dyshuarit (VIDEO)

5 Shtator, 16:05




Durrës/ Zbardhen 2 raste zjarrvënije, 3 të arrestuar! U dogjën dhjetëra hektarë tokë, qindra pemë frutore e ullinj

5 Shtator, 16:02




Sherr mes dy shoferësh furgonash në Kavajë, njëri goditet me levë në kokë (VIDEO)

3 Shtator, 13:48



Lajmi i fundit



Butrint, 1928

11 Shtator, 21:05

nga Alba Malltezi



RAPORTO! Chat live
me Shqipëria.com

